



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES

MINISTRI

U D H Ë Z I M

Nr. 12, datë 03.09 2015

PËR

**KRITERET E PËRZGJEDHJES SË USHTARAKËVE QË DALIN NË REZERVË KUR
BËHEN SHKURTIME NË NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PERSONELI TË
FORCAVE TË ARMATOSURA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenit 13, germa "F", të ligjit nr.64/2014, datë 26.06.2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", nenin 25, germa "dh", të ligjit nr.59/2014, datë 12.06.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozim të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA,

U D H Ë Z O J:

1. Të gjithë strukturat e Forcave të Armatosur, kur bëhen shkurtime në numrin e përgjithshëm të personelit duhet të zbatojnë kriteret e këtij udhëzimi për nxjerrjen në rezervë të personelit ushtarak.
2. Drejtoritë në MM, SHP, Komandat e Forcave, repartet dhe strukturat e tjera, kur ka shkurtime në numrin e përgjithshëm të personelit në Forcat e Armatosura, nxjerrja në rezervë e personelit ushtarak të bëhet në raport me moshën maksimale të qëndrimit në shërbim, vjetërsinë, arsimim/kualifikimin dhe specialitetin.
3. Kur bëhen shkurtime në numrin e përgjithshëm të personelit në Forcat e Armatosura trajtohen për të dalë në rezervë ushtarakët që:
 - a. kanë plotësuar një nga kushtet e përcaktuara në nenin 25 të ligjit nr.59/2014, datë 12.06.2014 "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë";
 - b. nuk kanë përparuar në gradë, kanë konsumuar afatet e shqyrtimit 2 ose 3 herë, sipas gradave dhe përcaktimit të bërë në pikën 2,3,4,5 të nenit 18 të po këtij ligji dhe u kanë mbetur edhe 2 vjet që të plotësojnë moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv sipas nenit 14, pika 1 të ligjit 59/2014.
 - c. nuk kanë kryer kurse institucionale të nevojshme për marrjen e gradës pasardhëse, nuk kanë një perspektivë të qartë për zhvillimin e karrierë dhe u ka mbetur jo më shumë se 2 vjet nga koha e plotësimit të moshës maksimale të qëndrimit në shërbim, sipas nenit 14 të të njëjtit ligj;

- d. u suprimohet funksioni organik në TOP dhe sistemimi në një detyrë tjetër nuk është i mundur;
 - e. kanë marrë masa disiplinore në mënyrë të përsëritje në 5 vjetët e fundit;
 - f. janë me mospërputhje me funksionin organik për një periudhë më shumë se 3 vjet apo që kanë kryer detyra në kushte të tilla më tepër se 1 herë;
4. Autoritetet gjatë procesit të përzgjedhjes së ushtarakëve për nxjerrjen në rezervë të mbajnë parasysh performancën, aftësitë profesionale, aftësitë intelektuale dhe kulturore, specialitetin përkatës, edukimin ushtarak, edukimin civil dhe trajnimet e kryera. Me qëllim që të mos dëmtohet operacionaliteti i FA-së të trajtohen me përparësi për t'u mbajtur në FA ushtarakët që:
- a. kanë kryer ose janë duke kryer detyra në shtabet e NATO-s, në përfaqësi, apo që janë me misione jashtë vendit;
 - b. sapo kanë përfunduar një kurs institucional apo sapo janë kthyer nga një mision jashtë vendit;
 - c. nuk kanë plotësuar kontratën e shërbimit ushtarak;
 - d. kryejnë detyra në pozicione kyçe;
 - e. kryejnë detyra specifike dhe me vështirësi shërbimi si në pikat e largëta të zbulimit, të ndërlidhjes, të batalionit special, batalionit komando etj, ku ka vështirësi për zëvendësimin e tyre;
 - f. kryejnë detyra në specialitete të tilla si: pilot, detari, jurist, informatikë, topografi, transport, inxhinieri, polumbar, armatim, etj, dhe zëvendësimi i tyre nuk është i mundur;
 - g. janë nënoficerë dhe ushtarë/detarë aktivë me arsim të lartë.
5. Përgjigjet për zbatimin e këtij udhëzimi gjithë strukturat e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura.
6. Ndjek zbatimin e këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm i MM-së dhe Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

